

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR

2019-2021

PER

AUDITIMIN E BRENDSEHEM NE SEKTORIN PUBLIK

NE BASHKINE MALESI E MADHE



Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Malësia e Madhe kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Bashkinë Shkodër.

Popullsia: Sipas regjistrit civil kjo bashki ka 53,918 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 951.01 km² me një densitet prej 56.69 banorë/km² sipas Regjistrit Civil .

Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Kopliku, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendra dhe Shkrelë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Koplik dhe Bajzë) dhe 56 fshatra.



Malësia e Madhe përmban bukuri të shumta natyrore, siç janë Liqeni i Shkodrës dhe pikat turistike malore të Vermoshit, Razmës dhe Bogës. Turizmi, blegtoria dhe bujqësia janë burimet kryesore ekonomike për banorët e kësaj zone.

Bashkia Malësi e Madhe, me qendër në Koplík është një bashki e re, që u krijua në vitin 2015, dhe si kryetar të parë të saj ka z. **Tonin Marinaj**.

I.1 Prioritetet e auditimit të brendshëm për vitin 2019

Ky plan strategjik ofron bazen për zhvillimin e Planit Vjetor të aktivitetit të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

Standarti për Planifikimin sipas IIA-së përcaktohet;

Standarti 2010-Planifikimi

Drejtuesi i auditimit duhet të hartojë planet mbi bazë risku për të përcaktuar prioritetet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, në pajtueshmëri me qëllimet e organizatës.

Misioni i Njesise Publike Bashkia Malësi e Madhe

- Sigurimi i qeverisjes të efekëshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
- Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- Realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- -Realizimin e shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Objektivat dhe prioritetet e njesise publike Bashkia Malesi e Madhe.

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse dhe tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimit;
- Një nga objektivat më të rëndësishëm do të jetë garantimi i pastërisë në rrugë dhe në hapësirat publike
- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit e sipërmarrjes;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- Ndërtimi i veprave të mëdha publike.

Në Planin Strategjik të konsoliduar për “Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” janë përcaktuar prioritetet për periudhën 2019-2021. Duke qënë se plani vjetor është dhe pjesë e planit strategjik, për vitin 2019 prioritet kryesor do të jenë: Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë në subjektet publike
- Rritja e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë; Zhvillimi dhe përsosja e kuadrit ligjor, procedural e rregullator, si dhe
- Ngritja dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore, për aftësimin e tyre në ushtrimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Njesine publike është e organizuar si Sektor në varësi të drejtpërdrejtë të Titullarit të Njesise Publike.

Kuadri ligjor ne Njesine Publike :

1. Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. Ligji nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
4. Ligji nr. 152/2013 datë 13.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 10294, datë 1.07.2010 “Për Inspektimin Financiar Publik.
6. VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Kuadri ligjor për Auditimin e Brendshëm në Njesine publike.

1. Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
2. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditimit të Brendshëm”;
3. VKM nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
4. VKM nr. 160, datë 2.3.2016 “Përmënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”;

5. Urdhri i Ministrisë së Financave nr. 86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik”

6. Manuali i Auditimit të Brendshëm viti 2016

Të gjitha këto do të ndihmojnë njësinë e AB-së të ndërtojë një pamje të asaj që organizata po përpiqet të arrijë dhe të risqeve me të cilat përballet.

Plani vjetor 2019 është një dokument që identifikon veprimtarinë e auditimit të brendshëm që parashikohet të kryhen nga NJAB në subjektet publike gjatë kësaj periudhe. Ky plan është një dokument fleksibël në të cilin prioritetet aktuale trajtohen në një ambient që ndryshon por sipas kërkesave të standarteve profesionale dhe do të jetë pjesë e dosjes së planit vjetor të çdo NJAB dhe e Planit të Konsoliduar. Plani është hartuar duke synuar pajtueshmërinë me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm. Plani Vjetor do të jetë një mjet për të monitoruar dhe harmonizuar veprimtarinë e strukturave audituese si dhe për të vlerësuar dhe pasqyruar ndryshimet e mundshme të risqeve me të cilat përballen subjektet publike për arritjen e objektivave.

I.2 Objektivat kryesore të AB për vitin 2019

Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë:

- Mbulimi me auditim i sistemeve/fushave ashtu siç është parashikuar në planin e vitit 2019 në këtë mënyrë AB i shton vlerë organizatave që auditohen.
- Realizimi i veprimtarisë së AB me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi, për të shtuar vlerë organizatave në sektorin publik, duke marrë në konsideratë risqet me të cilat përballen organizata, mjedisin e jashtëm ku ato veprojnë, kuadrin ligjor dhe rregulator, performancat e mëparshme dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në organizata.
- Kryerja e misioneve të AB në përputhje me Ligjin e ndryshuar të AB, Manualin dhe standardet e AB.
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

1.3 Identifikimi I sistemeve dhe fushave prioritare ;

Identifikimi i sistemeve dhe fushave për tu audituar është bërë në bazë të vlerësimit të riskut, të Ambjentit të Kontrollit të Brendshëm për çdo subjekt publik. NJAB-të, mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut kanë përcaktuar krahas sistemeve të përgjithshme dhe sisteme të veçanta për t'u audituar në çdo subjekt.

Struktura e Planit Strategjik

- Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB
- Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor
- Objektivat strategjik
- Identifikimi i subjekteve
- Identifikimi i fushave /sistemeve prioritare
- Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve
- Kufizimet e Auditimit
- Prioritetet për tre vite

Qëllimi i Planit Strategjik dhe Misioni i NJAB

Plani Strategjik është dokument i cili përcakton strategjinë për veprimtarinë e Auditimit e Brendshëm në Njesine Publike. Kjo strategji u përgatit për periudhën 2019-2021 nga Sektori I Auditimit të Brendshëm miratuar nga Titullari i Njesise Publike.

Plani strategjik 2019-2021 “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Njesine Publike, ka si qëllim identifikimin e sistemeve, fushave me nivel të lartë rrishtu, ku nëpërmjet analizës së tij përcakton mbulimin dhe frekuencën e auditimit.

Plani strategjik përcakton punën që do të ndërmerret nga Sektori i Auditimit të Brendshëm në Njesine Publike për periudhën e ardhshme 2019-2021.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm është pjesë e veprimtarisë aktuale të Njesise Publike duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin e lartë lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe të administrimit, i cili synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin e sistemeve, e fushave kryesore me risk më të lartë.

Hartimi dhe miratimi i planit strategjik është kërkesë e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjesi e drejtuesit të Sektorit të Auditit Brendshëm për hartimin dhe dërgimin për miratim tek Titullari I Njesise Publike dhe dërgimin për informim në Strukturën Përgjegjese për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Financës.

Sektori e Auditit të Brendshëm, duke u konsultuar e rënë dakort me menaxhimin lidhur me problemet e kontroleve të brendshme dhe administrimit, synon të zbatojë në mënyrë efektive mbulimin me auditim të veprimtarive kryesore dhe me risk të lartë të përcaktuar në këtë plan.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime, mbi bazën e një rishikimi të përgjithshëm të subjekteve që i nënshtrohen auditimit, identifikimit të sistemeve dhe fushave të veprimtarive mbi bazë risku, si dhe burimet njezore të planifikuara në dispozicion të Zyrës së Auditit të Brendshëm

VIZIONI: Te shtojë vlere nepermjet permiresimit te subjekteve te audituara ne njesine publike duke siguruar perdorimin me dobi, kursim,dhe frytshmeri te fondeve publike.

MISIONI : Misioni i Sektorit te Auditit të Brendshëm në Njesine Publike është që të ndihmojë Titullarin për të arritur objektivat e vendosura për Njesine publike,nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike duke vlerësuar dhe rekomanduar përmirësimin e frytshmërisë së menaxhimit të riskut dhe proceset e kontrollit të brendshëm,në drejtim të zbatimit e ligjit, rregullave dhe kontrolleve të vendosura, vleresimit të dobisë, frytshmërisë dhe efektivitetit të veprimeve. Dhënien në mënyre te pavarur të një sigurie te **arsyeshme** për Kryetarin e Njesis publike me qëllim:

- Përmirësimin e veprimtarisë së Njesise Publike dhe subjekteve vartëse të saj .
- Rritjen e frytshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- Shqyrtimin, vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për sistemet e kontrollit brendshëm për përmirësimin e tyre, për të arritur objektivat e caktuara duke përdorur burimet në mënyrë ekonomike dhe eficiente

Objektivat Strategjike të Sektorit te Auditimit të Brendshëm

- Të përdorë një metodologji Auditimi bashkëkohore që përputhet me standardet e pranuar ndërkombëtare të Auditimit dhe të Njesise Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.
- **Sigurimin** për Titullarin e Njesise Publike, të një sistemi vlerësimi eficient të burimeve dhe aseteve në njesine publike për: **Vlerësimin** e sistemit financiar për planifikimin dhe hartimin e buxhetit, **Vlerësimin** që kontrollet e brendshme janë të përshtatshme të parandalojnë gabimet, abuzimet, shpenzimet e tepërta,
- Rritjen e vazhdueshme të kualifikimit të auditëve përmes trajnimeve në fushën e procedurave dhe metodave/teknikave të auditimit si dhe teknikave mbi vlerësimin e riskut
- Rritja e cilësisë dhe e performancës së auditimeve me shtimin e numrit e cilësisë së zbulimeve si dhe impakt në rritje përse i përket përmirësimit të menaxhimit dhe shtimit të vlerës.
- Të raportojë në mënyrë periodike tek Titullari i Njesise publike për misionet e realizuara, problemet e evidentuara dhe rekomandimet në përmbushje të tyre.

Qellimi I planit strategjik eshte te percaktoje drejtimet ne te cilat do te zhvillohet veprimtaria e strukturave te auditimit te brendshem ne sektorin publik gjate periudhes per te cilen po hartohet ky plan ,kohen dhe burimet e nevojshme per realizimin e objektivave duke u bazuar ne analizen e riskut per fushat te cilat mbulon ky funksion .Te shtoje vleren nepermjet permirsimit te operacioneve te organizates ne sektorin publik duke siguruar perdorimin me dobi,kursim dhe frytshmeri te fondeve publike .

I.2 Objektivat kryesore të AB për vitin 2019

Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë:

- Mbulimi me auditim i sistemeve/fushave ashtu siç është parashikuar në planin e vitit2019 në këtë mënyrë AB i shton vlerë organizatave që auditohen.
- Realizimi i veprimtarisë së AB me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi, për ti shtuar vlerë organizatave në sektorin publik, duke marrë në konsideratë risqet me të cilat përballen organizata, mjedisin e jashtëm ku ato veprojnë, kuadrin ligjor dhe rregulator, performancat e mëparshme dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në organizata.
- Kryerja e misioneve të AB në përputhje me Ligjin e ndryshuar të AB, Manualin dhe standardet e AB.
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

ORGANIZIMI I NJAB DHE KUADRI LIGJOR

- Organizimi I NJAB; Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë Bashkise Malesi e Madhe është e organizuar në nivel -Sektori me varësi direkte nga Kryetari I Bashkise. Veprimtaria e sektorit të auditimit të brendshëm eshte strukture e re sepse me perpara nuk ka ekzistuar .Sektori përbëhet nga 3 vetë; 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
- Kuadri Ligjor ;Funksionimi I Auditit te Brendshem ne sektorin public bazohet ne ligjin nr 114 date 22.10.2015 ‘Per auditimin e brendshem ne sektorin publik’ ,Manualin e Auditimit te Brendshem si dhe ankte ligjore e nenligjore .

Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë:

- Mbulimi me auditim i sistemeve/fushave ashtu siç është parashikuar në planin e vitit2019 në këtë mënyrë AB i shton vlerë organizatave që auditohen.

- Realizimi i veprimtarisë së AB me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi, për të shtuar vlerë organizatave në sektorin publik, duke marrë në konsideratë risqet me të cilat përballen organizata, mjedisin e jashtëm ku ato veprojnë, kuadrin ligjor dhe rregulator, performancat e mëparshme dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në organizata.
- Kryerja e misionëve të AB në përputhje me Ligjin e ndryshuar të AB, Manualin dhe standardet e AB.
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

Identifikimi i subjekteve

Identifikimi i sistemeve dhe fushave për tu audituar është bërë në bazë të vlerësimit të riskut, të Ambjentit të Kontrollit të Brendshëm për çdo subjekt publik. NJAB-të, mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut kanë përcaktuar krahas sistemeve të përgjithshme dhe sisteme të veçanta për t'u audituar në çdo subjekt.

Subjektet :

- Bashkia Malesi e Madhe
- Njesia administrative Qender
- Njesia administrative Kastrat
- Njesia administrative Kelmend
- Njesia administrative Shkrel
- Njesia administrative Grumire
- Drejtoria e Administrimit të Pyjeve
- Sektori i Mirembajtjes së Rrugeve Rurale
- Struktura e Sektorit të MZSH Në Bashkinë Malesi e Madhe
- Sektori i Ujitjes dhe i Kullimit .
- Struktura e Gjendjes Civile
- Punonjësit e Arsimit Parashkollor Edukatore dhe Punonjësit në Qendrat Kulturorë

IDENTIFIKIMI I FUSHAVE/SISTEMEVE PRIORITARE

Auditi i Brendshëm duke ju referuar misionit që ka dhe qëllimit të tij ,identifikimin dhe vlerësimin e riskut për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut .Gjatë përgatitjes së planit strategjik 3-vjeçar vëmendja është fokusuar tek sistemet financiare dhe të përputhshme .Duke ju referuar këtyre sistemeve kemi bërë planifikimin e angazhimeve të auditimit me bazë sistemi për të gjitha fushat .

IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I RISQEVE

Bazat per zhvillimin e ketij plani jan risqet e identifikuara nga NJAB –te ,informacioni i mbledhur dhe i analizuar percakton dhe mbulimin e auditimeve per periudhen 2017-2019.Hartimi i ketij plani eshte fokusuar pikerisht ne prioritarizimin e risqeve te identifikuara.Planifikimi mbi baze risku perfshin procesin e kategorizimit te riskut sipas potencialit te tij

KUFIZIMET E AUDITIMIT

PRIORITET PER VITET (1+2)

PLANI VJETOR

Plani vjetor eshte nje dokument qe identifikon veprimtarine e auditimit te brendshem qe parashikohet te kryhen nga NJAB ne subjektet publike gjate kesaj periudhe .Ky plan eshte nje document fleksibel ne te cilin prioritetet aktuale ne nje ambient qe ndryshon qe ndryshon por sipas kerkesave te standarteve profesionale dhe do te jete pjese e dosjes se planit vjetor te cdo NJAB .Plani eshte hartuar duke synuar pajtuesmerine me detyrat dhe pergjegjesite e percaktuara ne kuadrin ligjor dhe Karten e Auditit te Brendshem .

Plani do te jete nje mjet per te monitoruar dhe harmonizuar veprimtarine e strukturave audituese si dhe per te vleresuar dhe pasqyruar ndryshimet e mundshme te risqeve me te cilat perballen subjektet publike per arritjen e objektivave .

STRUKTURA E PLANIT VJETOR

- Zhvillimet aktuale të NJAB
 - Prioritetet e auditimit për vitin
 - Objektivi (at) kryesore për vitin
 - Programimi i llojit të angazhimeve
 - Planifikimi i kostos për vitin
 - Planifikimi i burimeve për vitin
 - Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim
- Sigurimi i brendshëm i cilësisë

ZHVILLIMET AKTUALE TE NJAB

PRIOTITETET E AUDITIMIT PER VITIN

Në Planin Strategjik të konsoliduar për “Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” janë përcaktuar prioritetet për periudhën 2019-2021. Duke qënë se plani vjetor është dhe pjesë e planit strategjik, përveç prioritetëve të sipërpërmendura, për vitin 2019 prioritet kryesor do të jenë:

- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike;
- Kryerja e auditimeve në sistemet kryesore dhe me risk të lartë në subjektet publike, rritja e cilësisë së punës audituese për dhënien e rezultateve që shtojnë vlerë;
- Zhvillimi dhe përsosja e kuadrit ligjor, procedural e rregullator, si dhe
- Ngritja dhe zhvillimi profesional i burimeve njerëzore, për aftësimin e tyre në ushtrimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara.

OBJEKTIVAT KRYESORE TE AB

- Objektivat kryesorë të cilat synon të arrijë auditimi i brendshëm gjatë vitit në vijim janë: Mbulimi me auditim i sistemeve/fushave ashtu siç është parashikuar në planin e vitit 2019 në këtë mënyrë AB i shton vlerë organizatave që auditohen.
- Realizimi i veprimtarisë së AB me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi, për ti shtuar vlerë organizatave në sektorin publik, duke marrë në konsideratë risqet me të cilat përballen organizata, mjedisin e jashtëm ku ato veprojnë, kuadrin ligjor dhe rregullator, performancat e mëparshme dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në organizata.
- Kryerja e misionëve të AB në përputhje me Ligjin e ndryshuar të AB, Manualin dhe standardet e AB.
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

PROGRAMIMI I LLOJIT TE ANGAZHIMEVE .

BASHKIA MALESI E MADHE .

1-Kontrolle financiare per detyrimet e prapambetura te trashguar nga ish komunat.

2-Sektori I Kadastres urbani/zhv. Rural

3- Inspektoriati Vendor I mb/territorit

4-Sektori I Emergjencave Civile

5- Sekt.Pastrim-gjelb-mrmb-varreza

6-Kontrolle me tematika te nderyesheme sipas kerkesese te titullarit ne çdo kohe .

7-Sektori I sherbimeve te brenshme

Në përgatitjen e Planit Strategjik të AB-së, janë marre parasysh pritshmëritë e palëve të interesuara. Komunikimi me Titullarin e Njesise Publike, drejtoret e drejtorive perkatese pergjegjesit e sektoreve dhe administratorët e njesive administrative.Ky komunikim është i dobishëm për të shtuar efektivitetin e planifikimit të auditimit dhe për të hartuar një plan të aktiviteteve të auditimit, i cili do të përmbushë apo mund të adresojë më mirë nevojat e palëve të interesuara dhe t'u japë përparësi pritshmërive të tyre.

Llojet e riskut jane;

- Risku i institucionit qe mund te vije nga klima ekonomike, ndryshimet politike, ndryshimi i stafit etj.
- Risku i raportimit financiar qe ka te beje me pasqyrat financiare, regjistrimin e transaksioneve,kontrollin e brendeshem etj.
- Risku i auditimit kur raporti i auditimit nuk eshte i sakte ne lidhje me nje fushe auditimi.

Rregjistri i Riskut i Njesise Publike

BASHKIA MALESI E MADHE REGJISTRI I RISKUT					
Nr	Pershkrimi i Riskut	Risku para Kontrollit (probabiliteti/im pakti	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	
<i>Planifikimi I buxhetit dhe monitorimi I tij; Zbatimi I rregullave financiare dhe kontrolleve te auditit</i>					
1	<i>Propozime te reja jane kryer gjate mbedhjes se Keshillit per miratimin e buxhetit, vonojne veprimet</i>	<i>I ulet</i>	<i>Negociata me te gjitha sektoret</i>	<i>I ulet</i>	<i>sektori.finaces</i>
2	<i>Shpenzimet I kane tejkualuar te ardhurat</i>	<i>I mesem</i>	<i>Krahasimi mujor per cdo sektore . Kontroll I rrepte I Thesarit per cdo Urdher Shpenzimi</i>	<i>I ulet/</i>	<i>sektori.finaces</i>
3	<i>Planifikimi I bera nga Sektoret nuk eshte ne cdo rast te vleresuara drejt</i>	<i>I mesem</i>	<i>Krahasimi me vitin e kaluar. Shpjegime per ndryshimet</i>	<i>I ulet</i>	<i>sektori.finaces</i>
<i>Paga mujore, sigurimet shoqerore dhe shendetesore</i>					
1	<i>Informacionet per pagat nuk jepen ne kohe, pagat nuk merren ne kohe</i>	<i>I mesem</i>	<i>Koordinim me burimet njerezore per te respektuar afatet</i>	<i>I ulet</i>	<i>sektori.finaces</i>
2	<i>Kontributet shoqerore nuk paguhen ne kohe</i>	<i>I larte</i>	<i>Kontrollohet likujditeti</i>	<i>I mesem</i>	<i>sektori.finaces</i>
<i>Inventari I pronave</i>					
1	<i>Pronat bashkiake nuk kane vlere kontabile</i>	<i>I larte</i>	<i>Vakumi ligjor</i>	<i>I mesem</i>	<i>sektori.finaces</i>
<i>Dokumentim dhe arketimi I detyrimit te takses te subjekteve qe tregtojne karburant e vajra</i>					
1	<i>Mungesa e dokumentacionit perkates.</i>	<i>I larte</i>	<i>Pplotesimi I dokumentave dhe fillimi I arktimeve</i>	<i>I mesem</i>	<i>sektori.tatim takasve</i>

2	Specialistet e taksave nuk dokumentojne siç kerkon ligji veprimtarin esubjekteve	I larte	Kontroll ne tern dhe krahasimi me dokumentat e dosjes qe kan per subjektet.	I mesem	sektori.tatim taksave
Pagesat e te PAK dhe Ndhimes ekonomike					
1	Mosmbedhja ne kohen e duhur e keshillit bashkiak per te miratuar ndihmen ekonomike mujore	I larte	Kerkese drejtorise se Sherbimit social dhe komisionit ekonomik te KB	I ulet	sektori.finaces
Zgjerimi i bazes se taksueshme te bizneseve dhe familjeve					
1	Efektivitete I punes I zyres se taksave dhe bashkepunimi me sektoret	I larte	Takime dhe kerkesa zyrtare ndaj drejtorive te tjera, rritja e mundesive bashkevepruese dhe bashkepunuese per rritjen e nivelit te te ardhurave	I larte	Zyra e Taksave Regjistrimit te Biznesit .
Rritja e performances se administrates					
1	Kapitali njerezor	I larte	Rekrutimi I personelit mbeshtetur ne legjislacionit ne fuqi	I mesem	Sek. Men. te Burimeve Njerezore
2	Mungesa e kualifikimit cilesor	I larte	Percaktimi I indikatoreve te matshem (mesatarja e notave, kualifikime pasuniversitare, punime shkencore)	I mesem	Sek. Men. te Burimeve Njerezore
Rritje e cilesise se sherbimeve publike					
1	Shtimi I hapësirave publike	I mesem	Planifikimi I sherbimit ne keto zona per vitin pasardhes	I mesem	Drejtria e Koordinimit te Sherbimeve Publike
1	permbushjen e objektivit				
Menaxhimi I pronave					
1	Mospagesa ne kohe e detyrimeve te qirase	I larte	Kerkese ne Keshillin Bashkiak per uljen e mases se qirase per njesite qe ndodhen ne pozicione te disfavorshme	I mesem	Sekt. i Men. te Pronave
Prokurimet publike elektronike					
1	Nenshkrimi I kontrates ne afat e paracaktuara	I larte	Zbatimi I ligjit	I mesem	Sek.Jurid,prok.pub.
Administrimi i kerkesave per leje ndertimi					

1	Legjislacioni ne fuqi	I larte	Selektim i kerkesave per leje ndertimi	I larte	Sek.pla.territorit
2	Dokument pronesie	I larte	Adresim i popullates tek Zyra e Rregjistrimit	I larte	Sek.pla.territorit

Vlerësimi i nivelit të riskut për Njesine Publike viti 2019

		VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT			
Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
I	Bashkia Malesi e Madhe	Kontrolle financiare per detyrimet e prapambetura te trashguar nga ish komunat.	larte	-	-
1		Sektori I Kadastres urbani/zhv. rural	larte	-	-
2		Inspektoriat Vendor I mb/territorit	larte	-	-
3		Sektori I Emergjencave Civile	-	mesem	-
4		Sekt.Pastrim-gjelb-mrmb-varreza	larte		-
5		Kontrolle me tematika te nderyesheme sipas kerkesese se titullarit ne çdo kohe	larte	-	-
6		Sektori I sherbimeve te brenshme	larte	-	-

Në vijim jepet një parashikim i burimeve të auditimit në ditë njerëz bazuar në një bilanc tëmenaxhimit të burimeve të auditimit njerëz dhe ditë pune në dispozicion për vitin 2019.

Llogaritja është kryer bazuar në ditë pune të vlefshme në vit pa pushimet vjetore dhe festat zyrtare, si dhe njerëz auditues që janë në stafin e Sektorit të Auditimit për vitin 2019.

Nga koha efektive e punës në ditë/njerës, janë zbritur ditë njerëz që nevojiten për pushimet vjetore, festat zyrtare, pushimet javore, pushime për arsye shëndetësore, trajnime dhe angazhime të tjera si takime, mbledhje etj

Referuar këtyre treguesve në llogaritje dhe plotësimit të organikës garantoher realizimi i planit të auditimeve për vitin 2019 me një ngarkesë të plotë për punonjesin e njësisë së auditimit

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA		
	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlllogaritja e burimeve
	1	2	3
1	Koha maksimale e vlefshme	780	52 javex5 ditex3 persona
2	Pushime Vjetore	60	20 dite/person
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	39	13 dite / person
4	Pushime për arsye shëndetësore	12	4dite/person
5	Angazhime në trajnime	30	10dite/person
6	Angazhime në mbledhje/takime	12	takime cdo tre muaj
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	30	10dite/person
	TOTALI	597	199 dite/ person

PLANIFIKIMI I KOSTOS PER VITIN 2019

Llogaritja e buxhetit të auditimit është kryer mbi kalkulime të përafërta duke marrë parasysh të dhënat aktuale mbi numrin e audituesve ne rastin tone 3 auditues si dhe treguesit aktualë mbi pagat dhe shërbimet e tjera, si: energji, kancelari etj. Në bazë të llogaritjes, kosto për person për vitin 2019 me treguesit aktualë është rreth 781 mijë lekë.

Si treguesit e fondit të kohës dhe ato të koston mund të ndryshojnë nëse ndryshojnë treguesit e ndryshëm gjatë vitit 2019.

BUXHETI I PLANIFIKUAR

Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani
	1	2
1	Buxheti Gjithsej	2344
2	Paga dhe Sig.Shoqërore	2129
3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	135
4	Të tjera	80
5	Numri i Punonjësve	3
6	Kosto për Person (1/5)	781

Ky plan strategjik dhe vjetor pasi mori miratimin nga Kryetari i Bashkis Malesi e Madhe **z. Tonin Marinaj** është ne dispozicion te audituesve per tu relizuar dhe per te arritur objektivat .

PERGJEGJSI I SEKTORIT TE AUDITIT TE BRENDSHEM

TONIN TOMA